

VENDIM
Nr. 326, datë 15.12.2025

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 216, DATË 18.9.2025, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË ‘DIEZELA’ SHPK”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2358/8 prot., datë 13.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 216, datë 18.9.2025, ‘Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë ‘DIEZELA’ sh.p.k.’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, i ndryshuar, nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1.98 mw, me vendndodhje Përroi i Zallit të Madh, degë e përroit të Ljusës, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 216, datë 18.9.2025, ka miratuar dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e të licencuarit.

- Me shkresën nr. 2358/4 prot., datë 22.9.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në lidhje me vendimin e sipërcituar të Bordit të ERE-s.

- Në përgjigje, MIE i është drejtuar ERE-s me shkresën protokolluar në ERE me nr. 2358/5 prot., datë 5.11.2025 dhe i ka bërë me dije se ka pasur komunikim shkresor me shoqërinë, ku i ka sjell në vëmendje se ka konstatuar ndryshim të strukturës së ortakërisë së saj, pa pëlqimin paraprak të MIE-s, pra në kundërshtim me parashikimet e nenit 15 “Kufizime”, të kontratës, të datë 10.1.2015, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC “Ljusa”.

- Ndaj, ERE, me shkresën nr. 2358/6 prot., datë 13.11.2025, i është drejtuar shoqërisë dhe i ka kërkuar informacion/dokumentacion, në lidhje me sa më sipër referuar nga MIE.

- Shoqëria me shkresën nr. 2358/7 prot., datë 27.11.2025, ka sqaruar se ka vendosur të kthejë kuotat në gjendjen e mëparshme, d.m.th. të transferojnë pronësinë mbi kuotat e saj sërisht te Z.K M (që përfaqëson 100% të kapitalit).

- Në vijim, shoqëria ka përcjellë shkresën ku i është drejtuar MIE-s, datë 29.10.2025, protokolluar në MIE me nr. 29/10, datë 29.10.2025, më anë të së cilës kërkon miratimin e MIE-s, në lidhje me ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, specifikisht nga Z.K M (me 100% të kapitalit) tek Z.L M (55% të kapitalit) dhe Z.C Q (45% të kapitalit).

- Për gjithë sa më sipër, në përputhje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton, ndër të tjera, se një akt administrativ mund të anulohet ose të shfuqizohet nga organi publik që e ka nxjerrë, nga organi epror i tij, ose nga një organ tjetër kompetent, sipas ligjit, vlerësohet të shfuqizohet vendimi nr. 216, datë 18.9.2025, ‘Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë ‘DIEZELA’ sh.p.k.’. Si e tillë, kuotat e shoqërisë do të vijojnë të mbahen nga ortakut i shoqërisë Z.K M, sikurse rezultonin para vendimit të Bordit të ERE-s nr. 216, datë 18.9.2025, deri në momentin kur shoqëria të marrë miratimin e MIE-s, në lidhje me transferimin e kërkuar

dhe të depozitojë në ERE sa kërkuar në nenit 7 të rregullores nr. 235/2021, përfshirë kontratën e nënshkruar midis palëve, në mënyrë që të marrë autorizimin përkatës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 216, datë 18.9.2025, mbi kërkesën e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

2. Drejtoria e Licencimeve dhe Autorizimeve të lajmërojë shoqërinë “DIEZELA” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti